



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**AVOKATI I POPULLIT**  
**Seksioni i Përgjithshëm**

Adresa: Bulevardi: "Zhan D'Ark" Nr.2  
Tiranë, Shqipëri

Tel/Fax: +355 4 2380 300/315  
E-mail: [ap@avokatipopullit.gov.al](mailto:ap@avokatipopullit.gov.al)  
[www.avokatipopullit.gov.al](http://www.avokatipopullit.gov.al)

**Nr.**                      **Prot.**  
**Nr. Dok. 202400894/5**

**Tiranë** \_\_\_/\_\_\_/2025

**Lënda:**            *Rekomandim për marrjen e masave të menjëhershme për menaxhimin e mbetjeve në zonën e liqenit të Komanit*

**Drejtuar:**        **Bashkisë Tropojë**

**Tropojë**

**Bashkisë Shkodër**

**Shkodër**

**Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit**

**Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë**

**Tiranë**

*Të nderuar,*

Institucioni i Avokatit të Popullit, në përmbushje të mandatit të tij kushtetues dhe ligjor për garantimin e mbrojtjes së të drejtave, lirive dhe interesave të ligjshme të shtetasve nga veprimet apo mosveprimet e organeve të administratës publike, i kushton rëndësi të veçantë të drejtës për një mjedis të shëndetshëm. Në këtë kuadër, institucioni angazhohet në mënyrë të vazhdueshme për monitorimin sistematik të situatës mjedisore në territorin e Republikës së Shqipërisë, si dhe për vlerësimin e zbatueshmërisë së kuadrit ligjor dhe nënligjor për mbrojtjen e mjedisit nga autoritetet publike qendrore dhe organet e qeverisjes vendore.

Në këtë drejtim, duke marrë shkas nga shqetësimet e ngritura në median e shkruar dhe vizive, më konkretisht të një kronike me titull *“Ndotja e Liqenit të Komanit fenomen shqetësues! Vizitorët: Pamje të turpshme, të merren masa”*<sup>1</sup>, në përputhje me nenin 13, të Ligjit nr.8454 datë 4.02.1999 “Për Avokatin e Popullit”, të ndryshuar, ka filluar shqyrtimin me iniciativë të kësaj çështjeje. Sikundër thuhet shprehimisht në këtë kronikë, *“Liqeni i Komanit ofron pamje shqetësuese nga ndotja masive. Kudo shikon mbetje nga më të ndryshmet, ndërsa vizitorët e parë kërkojnë që të merren masa përpara se turistët e shumtë të mbërrijnë në vendin tonë”*. Në kronikë thuhet në vazhdim se, *“për të pastruar liqenin nga ndotja masive ka pasur ndërhyrje vullnetare, por për shkak të mungesës së pajisjeve përkatëse ata nuk kanë arritur që ta pastrojnë plotësisht. Liqeni i Komanit është krijuar më shumë se 45 vite më parë, teksa preferohet në masë për natyrën e egër që e rrethon.”*

Në vijim, me marrjen në shqyrtim të këtij rasti, kemi kërkuar informacion në mënyrë të përsëritur<sup>2</sup> në lidhje me problematikën e parashtruar në kronikë, trajtimin e mundshëm si dhe masat që janë marrë, apo janë parashikuar të ndërmerren, për zgjidhjen e kësaj situatë shqetësuese.

Në përgjigjen e përcjellë nga Bashkia Tropojë, bëhet e ditur se, në kuadër të zbatimit të planit vendor për menaxhimin e mbetjeve urbane, territori i bashkisë mbulohet në mënyrë të plotë me shërbim të organizuar pastrimi, përfshirë edhe njësinë administrative Fierzë, në të cilën bën pjesë edhe zona përreth Liqenit të Komanit. Në këtë kuadër, janë vendosur pika të dedikuara për grumbullimin e mbetjeve në çdo lagje dhe fshat, si dhe është parashikuar pastrimi periodik i brigjeve të lumenjve që derdhen në liqen, në përputhje me një grafik të miratuar.

Për lumin Valbonë, i cili përbën një ndër kontribuesit kryesorë në pellgun ujëmbledhës të Liqenit të Komanit, është në zbatim një plan i strukturuar për grumbullimin e mbetjeve përgjatë gjithë rrjedhës së tij, duke filluar nga burimi në fshatin Valbonë deri në segmentet e banuara. Megjithatë, Bashkia Tropojë nënvizon se nuk disponon kapacitetet financiare dhe teknike për ndërhyrje të drejtpërdrejtë në pastrimin e sipërfaqes ujore të liqenit, duke theksuar nevojën për projekte investimi me kosto të konsiderueshme në këtë drejtim. Si masë e mundshme parandaluese, përmendet vendosja e pritave ujore në grykëderdhjen e lumit Valbonë.

Ndër të tjera Bashkia Tropojë, nënvizon faktin se një burim i rëndësishëm i ndotjes së Liqenit të Komanit mbetet shkarkimi i mbetjeve nga Liqeni i Fierzës dhe lumi Shalë, të cilët ndodhen jashtë juridiksionit të Bashkisë Tropojë, konkretisht në territorin e Bashkisë Shkodër.

Institucioni i Avokati i Popullit, në kuadër të përgjigjes së marrë nga Bashkia Tropojë, vlerëson angazhimin e Bashkisë për përmirësimin e situatës mjedisore, përmes ndërhyrjeve të herëpashershme për pastrimin e zonës dhe evidentimit të ndotjes si një çështje me përparësi. Megjithatë këto veprime nuk janë të mjaftueshme për të përballuar nivelin në rritje të ndotjes,

<sup>1</sup> <https://shqiptarja.com/lajm/ndotja-e-liqenit-te-komanit-nje-fenomen-shqetesues-qytetaret-pamja-fantastike-por-ndotja-te-le-shume-per-te-deshiruar>

<sup>2</sup> 1. Shkresa nr. K1/I66-2 prot., datë 28.06.2024 drejtuar Bashkisë Tropojë

2. Shkresa nr K1/166-3 prot., datë 15.08.2024 drejtuar Bashkisë Tropojë

që vjen si pasojë e mungesës së një infrastrukture të përshtatshme dhe të mekanizmave të qëndrueshëm për menaxhimin e mbetjeve. Në këtë kuadër, është e nevojshme që Bashkia Tropojë të ndërmarë masa të planifikuara dhe të qëndrueshme, përfshirë hartimin e projekteve konkrete dhe sigurimin e fondeve nga Institucionet qendrore apo donatorë ndërkombëtarë, për investime në pajisje, logjistikë dhe teknologji të nevojshme për pastrimin dhe administrimin e mbetjeve.

Po ashtu një sfidë shtesë e identifikuar nga vetë Bashkia është ndotja që vjen përmes rrjedhjeve ujore nga jashtë territorit të saj administrativ, konkretisht nga Liqeni i Fierzës dhe lumi Shalë, të cilët ndodhen në juridiksionin e Bashkisë Shkodër. **Kjo rrethanë nënvizon domosdoshmërinë për një ndërhyrje të përbashkët ndërinstitucionale, që përfshin bashkitë përkatëse dhe institucionet përgjegjëse qendrore, me qëllim adresimin e plotë të burimeve të ndotjes dhe parandalimin e përshkallëzimit të saj.**

Në vijim, dëshirojmë të nënvizojmë faktin se Liqeni i Komanit, i krijuar në vitin 1979 me ndërtimin e digës së hidrocentralit, është shndërruar në një nga atraksionet më të rëndësishme turistike në veri të Shqipërisë. Sot, liqeni shërben si një korridor i rëndësishëm për turizmin natyror dhe kulturor, duke lidhur zonat malore me pjesën tjetër të vendit përmes transportit ujor dhe guidave turistike.

Për këtë arsye Bashkia Tropojë duhet të rrisë angazhimin e saj në krijimin dhe funksionimin e një Sistemi për Menaxhimin e Integruar të Mbetjeve, ndërgjegjësimin e komunitetit për menaxhimin e mbetjeve dhe bashkërendimin administrativ të strukturave të ndryshme qendrore dhe vendore, për zbatimin e legjislacionit mbi menaxhimin e integruar të mbetjeve, mbrojtjen e mjedisit dhe veçanërisht të zonave të mbrojtura.

Nga ana tjetër, Avokati i Popullit thekson faktin se strukturat e Bashkisë Tropojë në zbatim të kuadrit ligjor dhe nënligjor për mbrojtjen dhe garantimin e një mjedisi sa më të shëndetshëm, nuk duhet të neglizhohen detyrat dhe përgjegjësitë funksionale, në ofrimin e shërbimeve për qytetarët, duke vënë në dispozicion të tyre të gjithë mjetet dhe kapacitetet njerëzore dhe financiare që disponojnë me qëllim përmirësimin e standardit të jetesës.

Ndër të tjera, evidentohet se roli i bashkive në lidhje me menaxhimin e mbetjeve është përcaktuar nga Ligji 139/2015 *“Për vetë-qeverisjen vendore”*. Ky ligj rregullon organizimin dhe funksionimin e njësive të qeverisjes vendore dhe të organeve përkatëse në Republikën e Shqipërisë, si dhe përcakton funksionet, kompetencat, të drejtat dhe detyrat e tyre. Në mënyrë të veçantë, “grumbullimi, transportimi, asgjësimi dhe trajtimi i mbetjeve bashkiake” është përcaktuar si një funksion “i veti” i bashkive.

Sipas këtij përkufizimi, bashkitë kanë të drejtë dhe përgjegjësi për:

- Organizimin për ofrimin i shërbimit të grumbullimit, transportimit, trajtimit dhe depozitimit të mbetjeve bashkiake;
- Ndërtimin, pronësinë dhe operimin e objekteve të trajtimit;

- Vendosjen e tarifave të shërbimit për të mbuluar kostot e ofrimit të shërbimit dhe mbledhjen e të ardhurave.
- Organizimin dhe shpërndarjen e shërbimit të menaxhimit të mbetjeve në vetë bashkinë dhe/ose në bashkëpunim me një ose më shumë bashki të tjera, duke përdorur të gjithë instrumentat ligjorë dhe administrativë. Bashkitë janë kryesisht përgjegjëse për operimin e shërbimit të pastrimit, mbledhjen dhe transportin e mbetjeve në pikat e grumbullimit (stacionet e transferimit).

Po ashtu, ligji nr.10463/2011 “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve”, i ndryshuar, ngarkon Kryetarët e Njësisë të Qeverisjes Vendore si përgjegjës për menaxhimin dhe administrimin e mbetjeve që krijohen brenda territorit të tyre administrativ. Ndër të tjera, në këtë ligj përcaktohet se bashkitë kanë një rol të rëndësishëm dhe të domosdoshëm në menaxhimin e mbetjeve, përfshirë mbetjet inerte. Ato janë të detyruara të hartojnë dhe përditësojnë periodikisht plane vendore për menaxhimin e integruar të mbetjeve, duke ndjekur planet kombëtare dhe rajonale. Përgjegjësitë e bashkive përfshijnë përcaktimin e rregullave për grumbullimin, transportimin, trajtimin dhe depozitimin e mbetjeve, duke përfshirë mbetjet inerte në territorin e tyre.

Plani Kombëtar Sektorial për Menaxhimin e Mbetjeve 2020–2035 përfaqëson strategjinë afatgjatë të Shqipërisë për ndërtimin e një sistemi të integruar, funksional dhe të qëndrueshëm të menaxhimit të mbetjeve, në përputhje me standardet ndërkombëtare. Ky plan ndër të tjera parashikon përfshirjen aktive të bashkive në hartimin dhe zbatimin e planeve vendore, në përputhje me objektivat kombëtare dhe parimet e qëndrueshmërisë.

**Në këtë kuadër, Bashkia Tropojë ka detyrimin ligjor dhe institucional të hartojë një plan lokal për menaxhimin e mbetjeve, të cilin duhet ta zbatojë në mënyrë sistematike, në përputhje të plotë me strategjinë kombëtare dhe ligjin përkatës. Mungesa e një plani të tillë dhe e infrastrukturës përkatëse jo vetëm që çënon përmbushjen e detyrimeve ligjore, por përbën edhe një faktor direkt në përkeqësimin e gjendjes mjedisore në zonën e Liqenit të Komanit. Kjo sjellje institucionale pavarësisht shkaqeve krijon pasoja të dukshme për mjedisin, turizmin dhe cilësinë e jetës së banorëve lokalë.**

Përtej rolit thelbësor që Ligji nr. 10463, datë 22.09.2011 “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve” u njeh bashkive në menaxhimin efektiv të mbetjeve urbane, ai përcakton gjithashtu në mënyrë të qartë rolet dhe përgjegjësitë e institucioneve qendrore, veçanërisht të ministrive të linjës, në garantimin e funksionimit të sistemit kombëtar të menaxhimit të mbetjeve në përputhje me objektivat zhvillimore, mjedisore dhe shëndetësore.

Sa më lart, vërehet se fusha e menaxhimit të mbetjeve është e organizuar në një sistem me dy nivele, ku qeveria qendrore është përgjegjëse për strategjitë sektoriale dhe zhvillimin e politikave, dhe qeveritë vendore për ofrimin e shërbimeve. Qeveria qendrore ka rolin parësor të kanalizimit të fondeve të donatorëve dhe të thesarit për investime kapitale, bazuar në vlerësimin e nevojave sipas Planeve Kombëtare dhe nevojës që vijnë nga qeveritë

vendore/bashkitë. Në rastin konkret, Ministria për Mjedisin dhe Ministria për Infrastrukturën dhe Energjinë janë institucionet përgjegjës për zhvillimin e politikave kryesore në fushën e menaxhimit të mbetjeve, në mbulimin e investimeve për infrastrukturën dhe hartimin e standardeve dhe teknikave më të mira për menaxhimin e mbetjeve bashkiake dhe mbetjeve nga ndërtimet dhe prishjet. Këto ministri kanë përgjegjësinë e plotë për krijimin dhe monitorimin e zbatimit të sistemit të menaxhimit të mbetjeve në nivel rajonal dhe vendor.

Ministria e Turizmit dhe Mjedisit, si autoriteti përgjegjës për politikat kombëtare mjedisore, luan një rol thelbësor në formulimin dhe zbatimin e strategjive për menaxhimin e integruar të mbetjeve. Sipas kuadrit ligjor dhe dokumenteve strategjike në fuqi, kjo ministri është përgjegjëse për hartimin e politikave afatgjata, siç është Plani Kombëtar Sektorial për Menaxhimin e Mbetjeve të Ngurta 2020–2035, për mbikëqyrjen dhe koordinimin e zbatimit të këtyre politikave nga qeveritë vendore përmes udhëzimeve, planeve të veprimit dhe kontrolleve të rregullta, si dhe për zhvillimin e kuadrit normativ dhe teknik për trajtimin dhe asgjësimin e mbetjeve në përputhje me standardet evropiane.

Ministria është gjithashtu përgjegjëse për ngritjen dhe monitorimin e sistemit të menaxhimit të mbetjeve *Në rastin e zonës së Liqenit të Komanit, që është njëkohësisht burim natyror, rezervuar hidrik, dhe atraksion turistik, Ministria ka detyrimin jo vetëm të vlerësojë ndikimet kumulative të ndotjes nga mbetjet urbane dhe rrjedhat ujore, por edhe të ndër marrë ndërhyrje ndërinsticionale koordinuese për të parandaluar dëmtimin e mëtejshëm të mjedisit dhe imazhit turistik të zonës.*

Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, nga ana tjetër, mban përgjegjësi të rëndësishme në aspektin e ndërtimit dhe zhvillimit të infrastrukturës së nevojshme për trajtimin e mbetjeve. Kjo përfshin planifikimin dhe ndërtimin e landfilleve sanitare, qendrave të përpunimit, sistemit të transferimit dhe depozitimit të mbetjeve në nivel rajonal, si dhe sigurimin e financimeve përmes buxhetit të shtetit, partneriteteve publike-private apo fondeve ndërkombëtare për projekte që i tejkalojnë kapacitetet e vetë bashkive.

*Në rastin e Bashkisë Tropojë dhe zonës përreth Liqenit të Komanit, mungesa totale e infrastrukturës për grumbullimin, trajtimin dhe depozitimin e mbetjeve, si dhe mungesa e çdo investimi për pastrimin sistematik të brigjeve dhe sipërfaqes ujore, dëshmon për mungesë të theksuar të vëmendjes dhe ndërhyrjes së koordinuar nga kjo ministri, pavarësisht detyrimeve të qarta që i ngarkon ligji.*

**Në dritën e parashtrimeve të mësipërme, Avokati i Popullit konstaton me shqetësim se mungesa e vëmendjes së institucioneve përgjegjëse, si në nivelin vendor ashtu edhe në atë qendror, ka sjellë një përkeqësim të ndjeshëm të gjendjes mjedisore në zonën e Liqenit të Komanit, duke cenuar drejtpërdrejt të drejtën kushtetuese të qytetarëve për një mjedis të pastër dhe të shëndetshëm. Mungesa e investimeve të qëndrueshme, e ndërhyrjeve të koordinuara ndërinsticionale dhe e mekanizmave të kontrollit e monitorimit të ndotjes tregon një moszbatim të detyrimeve ligjore dhe strategjike që rrjedhin nga kuadri kombëtar dhe ndërkombëtar për mbrojtjen e mjedisit.**

Në këtë kuadër, Avokati i Popullit nënvizon domosdoshmërinë për marrjen e menjëhershme të masave konkrete nga të gjitha autoritetet përkatëse përfshirë Bashkinë Tropojë, Bashkinë Shkodër, Ministrinë e Turizmit dhe Mjedisit, dhe Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë me qëllim ndalimin e përhapjes së ndotjes, rehabilitimin e zonës dhe ndërtimin e një sistemi funksional dhe të qëndrueshëm për menaxhimin e mbetjeve, në përputhje me ligjin dhe standardet ndërkombëtare që Shqipëria ka ratifikuar.

Mosmarrja e masave të nevojshme në vijim mund të përbëjë jo vetëm një mangësi në zbatimin e detyrimeve administrative, por edhe një cënim të të drejtave themelore të garantuara me ligj. Një situatë e tillë do të minonte besimin e qytetarëve në funksionimin efektiv dhe të përgjegjshëm të institucioneve publike, si dhe pritshmëritë për mbrojtjen e interesit të përbashkët. Mungesa e koordinimit ndërinstitucional dhe mosvëmendja ndaj gjendjes mjedisore në zonën e Liqenit të Komanit përbëjnë një shqetësim serioz në raport me të drejtën për një mjedis të pastër dhe të shëndetshëm, si dhe rrezikojnë të dëmtojnë potencialin turistik të zonës dhe zhvillimin e saj të qëndrueshëm.

**Në këtë kontekst, Avokati i Popullit, në përmbushje të misionit të tij kushtetues për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive themelore të individit, dhe duke u udhëhequr nga parimet ligjshmërisë dhe të mirëfunksionimit të administratës publike, çmon të nevojshme adresimin e këtij rekomandimi për veprim dhe ndërhyrje të menjëhershme nga organet përgjegjëse.**

Për sa më sipër, Institucioni i Avokatit të Popullit i kërkon Bashkisë Tropojë të ndërmarrë pa vonesë hartimin dhe miratimin e një plani emergjent për pastrimin e liqenit të Komanit, i cili duhet të përfshijë masa konkrete si vendosjen e barrierave penguese mbi ujë, pajisjen me mjete teknike për grumbullimin dhe menaxhimin e mbetjeve lundruese. Në mënyrë të ngjashme, Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë dhe Ministria e Turizmit dhe Mjedisit, duhet të vërë në dispozicion fonde të dedikuara për mbështetjen e këtij procesi, të hartojë udhëzime teknike të qarta për ndërhyrjen. Vetëm përmes një angazhimi të koordinuar ndërmjet pushtetit vendor dhe institucioneve qendrore mund të sigurohet ruajtja e integritetit mjedisor të Liqenit të Komanit, mbrojtja e shëndetit publik dhe promovimi i turizmit të qëndrueshëm në këtë zonë me rëndësi të veçantë për natyrën dhe zhvillimin lokal.

Në analizën e përgjegjësisë institucionale për ndotjen e vazhdueshme të Liqenit të Komanit, është e rëndësishme të theksohet se Shqipëria ka marrë një sërë angazhimesh ndërkombëtare të cilat përforcojnë dhe konkretizojnë detyrimet e saj për mbrojtjen e mjedisit dhe menaxhimin e integruar të mbetjeve. Këto instrumente ndërkombëtare jo vetëm e ngarkojnë shtetin shqiptar me përgjegjësi shtesë, por në mënyrë të veçantë vënë në pah rëndësinë e transparencës, planifikimit dhe zbatimit efektiv të masave për mbrojtjen e burimeve ujore, siç është edhe Liqeni i Komanit.

Së pari, Konventa e Aarhusit, e ratifikuar nga Shqipëria në vitin 2000, garanton të drejtën e qytetarëve për akses në informacion, pjesëmarrje në vendimmarrje dhe qasje në drejtësi në çështjet që lidhen me mjedisin. Në këtë kuadër, vërehen mangësi të theksuara në komunikimin

institucional dhe përfshirjen e komunitetit lokal në proceset që lidhen me gjendjen e liqenit, çka tregon nevojën për përmirësime në zbatimin e kësaj konvente.

Gjithashtu, Marrëveshja e Parisit për Klimën, e ratifikuar nga Shqipëria në vitin 2016, thekson rëndësinë e zhvillimit të qëndrueshëm dhe mbrojtjes së ekosistemeve natyrore. Praktikrat aktuale që lidhen me ndotjen e Liqenit të Komanit, për shkak të mungesës së infrastrukturës për menaxhimin e mbetjeve dhe pastrimin e trupave ujore, sugjerojnë mospërputhje me parimet e kësaj marrëveshjeje dhe nënvizojnë nevojën për veprim më të koordinuar dhe të qëndrueshëm.

Në këtë drejtim, zbatimi i Direktivave të Bashkimit Evropian për mjedisin, të cilat Shqipëria është zotuar t'i përafrojë si pjesë e procesit të integritimit evropian, është vendimtar. Direktiva Kuadër për Ujërat (2000/60/EC) kërkon ruajtjen e statusit të mirë ekologjik të ujërave sipërfaqësore, ndërsa Direktiva për Ujërat e Ndotura Urbane (91/271/EEC) dhe Direktiva për Mbetjet (2008/98/EC) përcaktojnë standarde të qarta për menaxhimin e mbetjeve dhe mbrojtjen e mjedisit. Mungesa e infrastrukturës dhe trajtimi i mbetjeve në zonën e Tropojës tregon nevojën për ndërhyrje të menjëhershme dhe përmirësim e kapaciteteve institucionale dhe teknike në këtë drejtim.

Për rrjedhojë, situata aktuale në Liqenin e Komanit pasqyron jo vetëm sfidat e brendshme në menaxhimin mjedisor, por edhe nevojën për një përputhje më të plotë me angazhimet ndërkombëtare që Shqipëria ka ndërmarrë, qoftë përmes marrëveshjeve ku është palë, apo si vend në procesin e anëtarësimit në Bashkimin Evropian. Zbatimi i tyre në praktikë është thelbësor jo vetëm për përmbushjen e detyrimeve ligjore, por edhe për të garantuar një mjedis të shëndetshëm për qytetarët dhe për brezat që vijnë.

Ndër të tjera, është e rëndësishme të përmendim, se rasti i ndotjes së Liqenit të Komanit vë në dukje sfidat e theksuara të bashkëpunimit ndërinstitucional në menaxhimin e ndotjes që buron nga territore të ndryshme administrative, siç është ajo e Bashkisë Shkodër. Ky liqen, i krijuar nga ndërtimi i hidrocentralit mbi lumin Drin, mbledh dhe mbetjet që vijnë përmes rrjedhave ujore që përshkojnë këtë territor. Ndër to, një ndikim të veçantë ka lumi Shalë, i cili, ndonëse i njohur për vlerat e tij natyrore dhe turistike, kontribuon gjithashtu në transportimin e mbetjeve që derdhen në liqen, për shkak të mungesës së infrastrukturës së menaxhimit të mbetjeve në zonat përreth. Si rezultat, pavarësisht se Liqeni ndodhet gjeografikisht në një pjesë të madhe brenda kufijve të Bashkisë Tropojë, ndotja e tij është në një masë të konsiderueshme pasojë e mbetjeve që vijnë nga rrjedha të sipërme, përfshirë ato që përkasin territorialisht Bashkisë Shkodër.

Mungesa e një mekanizmi të përbashkët ndërmjet këtyre dy bashkive ka sjellë një situatë ku nuk ka ndarje të qartë të përgjegjësiave, nuk ka koordinim në ndërhyrje dhe as përdorim të drejtë të burimeve teknike dhe financiare. Për ta adresuar këtë situatë komplekse, është e domosdoshme ngritja e një strukture të përbashkët koordinuese ndërbashkiake, me pjesëmarrjen e Bashkisë Tropojë dhe Bashkisë Shkodër, që do të ketë përgjegjësi të qarta për trajtimin e ndotjes së liqenit në mënyrë gjithëpërfshirëse. Kjo strukturë duhet të mbështetet nga

Ministria e Turizmit dhe Mjedisit dhe Ministria e Brendshme, në mënyrë që të ketë kapacitetin e duhur institucional dhe financiar për të vepruar në kohë.

Paralelisht, një marrëveshje bashkëpunimi ndërmjet dy bashkive do të shërbente si bazë për ndarjen e detyrave, kostove dhe burimeve, vetëm përmes një bashkëpunimi të strukturuar, ku çdo institucion të ketë një rol të qartë dhe të barabartë, mund të sigurohet një menaxhim i qëndrueshëm dhe efektiv i Liqenit të Komanit, si një pasuri natyrore dhe potencial të lartë zhvillimi për zonën.

Në analizë të fakteve të mësipërme, institucioni i Avokatit të Popullit synon që jo vetëm të sensibilizojë organet kompetente, por edhe t'i verë në lëvizje ato për vetë rëndësinë që ka kjo problematikë. Ndaj ne ritheksojmë edhe njëherë domosdoshmërinë e veprimeve konkrete për zgjidhjen përfundimtare të problemit të ndotjes së mjedisit në zonën e Liqenit të Komanit

Në këtë kuadër, duke patur parasysh se kjo është një çështje e rëndësishme për qytetarët, të cilëve duhet ti grantohet e drejta për një mjedis të shëndetshëm, **Avokati i Popullit dëshiron të sjellë në vëmendjen tuaj ushtrimin e përgjegjësive ligjore me fokus të veçantë në zbatimin me rigorozitet të dispozitave të akteve ligjore dhe nënligjore, me qëllim që të ndikojmë në përmirësimin e gjendjes së mjedisit në Shqipëri, si edhe garantimin e standardeve të një mjedisi sa më të shëndetshëm.** Në vijim konstatojmë se është thelbësore ndërmarrja e veprimeve konkrete dhe planifikimi i investimeve në infrastrukturë për zgjidhjen e situatës së krijuar.

Për sa më sipër, për të gjitha arsyet që parashtuam, bazuar në nenin 63/3 të Kushtetutës ku përcaktohet se: *“Avokati i Popullit ka drejtë të bëjë rekomandimet dhe të propozojë masa kur konstaton shkelje të të drejtave dhe lirive të njeriut nga Administrata Publike...”*, si dhe në bazë të Nenit 21/b të ligjit Nr.8454/1999 *“Për Avokatin e Popullit”* (me ndryshimet përkatëse), ku përcaktohet se: *“Avokati i Popullit paraqet rekomandime për vënien në vend të së drejtës së shkelur tek organi administrativ që sipas tij ka shkaktuar shkelje të të drejtave dhe lirive”*:

## REKOMANDOJMË

- Marrjen e masave nga Bashkia Tropojë për hartimin dhe zbatimin e menjëhershëm të një Plani Vendor për Menaxhimin e Mbetjeve, në përputhje me Planin Kombëtar Sektorial për Menaxhimin e Mbetjeve të Ngurta 2020–2035, me fokus të veçantë në zonat përreth Liqenit të Komanit dhe lumit Valbonë.
- Marrjen e masave nga Ministria e Turizmit dhe e Mjedisit dhe Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë për planifikimin në buxhetin afatmesëm të një fondi të dedikuar për përmirësimin e infrastrukturës për menaxhimin e integruar të mbetjeve.
- Marrjen e masave për koordinimin dhe bashkërendimin e punës dhe vëmprimtarisë ndërmjet Ministrive përgjegjëse dhe Njësive të Qeverisjes vendore në ushtrimin e kompetencave të tyre për menaxhimin e mbetjeve
- Marrjen e masave për pajisjen dhe operimin me mjete të specializuara për pastrimin e sipërfaqeve ujore, si dhe krijimin e një njësie teknike të përhershme për ndërhyrje në ujë dhe në brigjet përreth.

- Marrjen e masave për përcaktimin e buxhetit të nevojshëm dhe identifikimin e burimeve të qëndrueshme të financimit për zbatimin e masave të menaxhimit të mbetjeve.
- Marrjen e masave për krijimin e qendrave të transferimit të mbetjeve në fshatrat përreth liqenit dhe përgjatë rrjedhës së lumit Valbonë, për të përmirësuar efikasitetin e sistemit të grumbullimit.
- Marrjen e masave për realizimin e inspektimeve të vazhdueshme dhe të paparalajmëruara në terren, për identifikimin dhe ndalimin e shkarkimeve të paligjshme.
- Marrjen e masave për formalizimin e marrëveshjeve të bashkëpunimit ndërinstucional ndërmjet Bashkisë Tropojë me Bashkinë Shkodër dhe ministrive përkatëse për ndarjen e përgjegjësi, kostove dhe resurseve teknike për pastrimin dhe për menaxhimin e ndotjes në liqenin e Komanit.
- Marrjen e masave për organizimin e fushatave të vazhdueshme ndërgjegjësimi dhe edukimi mjedisor, në bashkëpunim me institucionet arsimore, operatorët turistikë dhe shoqërinë civile.
- Marrja e masave për vendosjen e sinjalistikës orientuese dhe paralajmëruese në të gjitha pikat turistike dhe zonat me ndjeshmëri të lartë mjedisore, me qëllim rritjen e ndërgjegjësimit dhe orientimin e vizitorëve drejt sjelljeve të përgjegjshme.

Për qëndrimin që do të mbani ndaj kësaj kërkesë dhe masën disiplinore që do të merrni, na vini në dijeni brenda afatit ligjor 30 ditor, të parashikuar në nenin 22 të ligjit nr. 8454, datë 04.02.1999 "*Për Avokatin e Popullit*", i ndryshuar.

*Duke besuar në mirëkuptimin dhe bashkëpunimin tuaj,*

**K O M I S I O N E R**

**Vilma SHURDHA**